


GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

**Raporti i Audituesit të pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

100

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN E MBYLLUR	5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	7
SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	8 - 25



RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për: Ortakut të vetëm të shoqërisë dhe Drejtimit të GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk.

Adresa: Rruga e Elbasanit, Ndertesa 'Park Gate', Kati Pare, Tirana, Shqipëri

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Standardet e Kontabilitetit të SNRF-ve të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të shoqërisë GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk nuk janë audituar më parë. Ne jemi të vetëdijsëm për këtë dhe e kemi marrë parasysh si pjesë të procesit tonë të auditimit.

Informacione të Tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin e ecurisë, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me Nenet 17 dh 19 të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinionin në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në të ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raportauditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materialenëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për

procesine auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jopër të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, eçmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne, gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet, në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar personave të ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishmet për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të periudhës aktuale dhe, për pasojë, edhe çështje kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditimit përveç nëse në rastin kur ligji ose rregullat e ndalojnë bërjen publike të çështjes ose kur, në rast të jashtëzakonisht të rralla, ne vendosim që çështja të mos komunikohet në raportin tonë për arsye se pasojat negative nga një komunikim i tillë pritet në mënyrë të arsyeshme të tejkalojnë përfitimet në favor të interesit publik.

“Public Accounting Service Union and Trust” sh.p.k.

Rr. “Themistokli Gërmenji” Pallati Ambasador I, Kati I-rë Tirana – Albania

Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): L21423032S

Audites Ligjor
Ilda Duhanxhiu



Eljona Hoxha PF
Rr. Tefta Tashko Koço, Nd. 41, H2, kati VII, Tirana
Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS): M12213005N

Auditues Ligjor
Eljona Hoxha



Tiranë, më 28 mars 2025

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

AKTIVET	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Aktive afatgjata			
Investime në filiale	4	272,142,600	220,110,100
Aktive jo-materiale	5	15,664,500	15,664,500
Totali i aktiveve afatgjata		287,807,100	235,774,600
Aktivet afatshkurtra			
Investime ne aktive financiare	6	766,588,797	820,247,274
Llogari të arkëtueshme	7	1,423,042	-
Të tjera të drejta afatshkurtra	8	1,421,507,455	851,492,859
Të tjera të arkëtueshme	9	134,490,948	110,688,332
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	10	16,788,126	2,491,627
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,340,798,368	1,784,920,092
TOTALI I AKTIVEVE		2,628,605,468	2,020,694,692
KAPITALI			
Kapitali i Nënshkruar	11	99,220,506	99,220,506
Rezerva ligjore	11	95,667,397	-
Rezerva të tjera	11	1,004,173,002	-
Humbja e mbartur			(185,228)
Fitimi i vitit	11	930,603,267	1,913,347,936
Totali i kapitalit (neto)		2,129,664,172	2,012,383,214
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Detyrime financiare	12	487,609,504	-
Totali i detyrimeve afatgjata		487,609,504	-
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime financiare	13	-	6,232,800
Detyrime tregtare	14	9,850,960	1,960,714
Të pagueshme ndaj punonjësve	15	-	109,854
Të pagueshme për detyrime tatimore	16	1,480,832	8,110
Totali i detyrimeve afatshkurtra		11,331,792	8,311,478
Totali i detyrimeve		498,941,296	8,311,478
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,628,605,468	2,020,694,692

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk më datë 05/03/2025 dhe u nënshkruan në emër të saj nga përfaqësuesi ligjor:

Znj. Kristjana Zhamo
Përfaqësues ligjor

Kristjana Zhamo
K Zhamo


Mimoza Korbeci
Përgatitëse e pasqyrave financiare

Mimoza Korbeci


Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 23 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

K Zhamo

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
TE ARDHURAT E SHFRYTEZIMIT			
Të ardhurat nga aktiviteti		-	-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		-	-
Totali të ardhurave nga shfrytëzimi		-	-
SHPENZIME OPERATIVE			
Kosto të shfrytëzimit		-	-
Shpenzime personeli	17	(1,363,491)	(971,100)
Shpenzime amortizimi		-	-
Shpenzime të tjera	18	(2,120,895)	(131,358)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(3,484,386)	(1,102,458)
TE ARDHURAT TE TJERA			
Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	19	1,006,885,592	1,922,547,600
Të ardhurat nga investimet dhe huatë pjesë e aktiveve afatgjata	19	39,233,953	27,999,427
Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme			
Totali të ardhurave të tjera		1,046,119,545	1,950,547,027
Zhvierësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra			
Shpenzime financiare neto	20	(19,970,673)	(13,815,649)
Humbje neto nga kurset e këmbimit	20	(92,061,219)	(22,280,984)
Totali i shpenzimeve financiare, neto		(112,031,892)	(36,096,633)
FITIMI PARA TATIMIT		930,603,267	1,913,347,936
Shpenzimi tatim-fitimit	21	-	-
FITIM/(HUMBJA) e vitit			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (diferenca perkthimi te akumuluar)			
Fitimi gjithëpërfshirës për vitin			

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8 – 23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		
Fitim/ Humbja e periudhes	930,603,267	1,913,347,936
Rregullime per shpenzimet jomonetare:	-	-
Shpenzimet financiare jomonetare	-	-
Shpenzimet financiare jomonetare interesa per tu arketuar	(23,163,400)	(27,999,427)
Shpenzime konsumi & amortizimi	-	-
Zhvleresimiul aktiveve afatgjata materiale	-	-
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:	-	-
Renie / (rritje) ne te drejlat e arketueshme dhe te tjera	(572,076,854)	(2,152,864,634)
Renie / (rritje) ne inventare	-	-
Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme	7,890,246	1,960,714
Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit	(109,854)	15,692
Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera	(4,760,078)	-
Te tjera (pershkruaj) Aktive Financiare	53,658,477	-
Renie (rritje) ne te drejlat e arketueshme kapital I paguar	-	94,220,506
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	392,041,804	(171,319,213)
II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit		
a. Para te perdorura per blerjen e filialeve (shuma neto)	(52,032,500)	(220,110,100)
b. Para te arketuara nga shitja e filialeve (shuma neto)	-	-
c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	-
d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera	-	-
f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera	-	(820,247,274)
g. Dividende te arketuar	-	1,922,547,600
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit	(52,032,500)	882,190,226
III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit		
a. Arketime nga emetimi I kapitalit	-	-
b. Arketime nga emetimi I aksioneve te perdorura si kolateral	-	-
c. Hua te arketuara	487,609,504	(713,322,308)
d. Pagesa e kostove te transakcionit qe lidhen me kredite dhe huate	-	-
e. Riblereje e aksioneve te veta	-	-
f. Pagesa e aksioneve te perdorura si kolateral	-	-
g. Pagesa e huave	-	-
h. Pagesa e detyrimeve te qirase financiare	-	-
i. interes I paguar	-	-
j. Dividende te paguar	(813,322,309)	-
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit	(325,712,805)	(713,322,308)
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	14,296,499	(2,451,295)
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	2,491,627	4,942,922
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	16,788,126	2,491,627

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8–23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më 31 dhjetor 2024

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2023	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	99,220,506	-	-	(185,228)	-	99,035,278
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	1,913,347,936	1,913,347,936
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	-	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	99,220,506	-	-	(185,228)	1,913,347,936	2,012,383,214
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2024	99,220,506	-	-	(185,228)	1,913,347,936	2,012,383,214
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	1,913,162,708	-	1,913,162,708
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:	-	-	-	-	930,603,267	930,603,267
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	-	-	-	-	-
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	95,667,397	1,004,173,002	(1,099,840,399)	-	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike	-	-	-	(813,322,309)	-	-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2024	99,220,506	95,667,397	1,004,173,002	-	930,603,267	2,129,664,172

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 8-23 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Handwritten signature

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k. (në vijim referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me datë 10 gusht 2022 nën formën juridike shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me NIPT M22010013H. Shoqëria është themeluar dhe zotërohet nga ortakut i vetëm Marin Gjona dhe zotëron një kapital nënshkruar prej 99,220,506 Lekë i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 99,220,506 Lekë (2023: 99,220,506 Lekë i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 99,220,506 Lekë).

Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Rruga e Elbasanit Ndërtesa "Park Gate", kati i parë, Tiranë. GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk ka si aktivitet kryesor:

- Investime në instrumente financiare, të cilat përfshijnë pa kufizim titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare (kuotat dhe aksionet), titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh, obligacione private ose publike ndërkombëtare etj.,
- Themelimin dhe zotërimin e shoqërive tregtare, pjesërisht ose tërësisht;
- Investime në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme,
- Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj, tërësisht ose pjesërisht, dhe/ose të tretë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në konsulencën e natyrës financiare, menaxheriale, ligjore, IT, zhvillim software-sh

Përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë është Znj. Kristjana Zhamo.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 2 (31 dhjetor 2023: 2).

Për shkak të ndryshimeve ligjore në Republikën e Shqipërisë (vendimi nr.17 datë 16 Janar 2019), GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk klasifikohet tashmë si Njësi me Interes Publik (NJIP. Referuar vendimit të sipër përmendur "Shoqëri që vlerën e totalit të aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë;

2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), miratuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Vlerat e përfshira në pasqyrat financiare të Shoqërisë maten duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ('monedha funksionale'). Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, që është dhe monedha funksionale e Republikës së Shqipërisë si edhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vlerësime dhe gjykime kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kërkon ushtrimin e gjykimit në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjithashtu kërkon nga Drejtimi i Shoqërisë ushtrimin e gjykimit mbi aplikimin e politikave kontabël. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë më të lartë gjykimi, që kanë një shkallë të lartë kompleksiteti, apo ato për të cilat supozimet dhe vlerësimet kanë ndikim të madh për pasqyrat financiare, janë pershkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

2.5 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të jetë në gjendje të shfrytëzojë aktivet e saj dhe shlyejë detyrimet e saj gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Gjatë vitit 2024, GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k. nuk u ndikua nga ndryshimet e ndodhura në politikat publike. Sidoqoftë, nëse një situatë e tillë do të ishte materializuar, ne kemi model fleksibël të biznesit, infrastrukturë të përshtatshme dhe njohuri të mjaftueshme në mënyrë që të adoptojmë dhe përshtatemi me ndryshime të tilla, nëse është e nevojshme.

Shoqëria administron burimet dhe investimet e saj në një mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj në çdo kohë. Shoqëria planifikon flukse monetare në baza ditore, duke zbatuar një politikë të menaxhimit të rregullt të likuiditetit, e cila miratohet nga Drejtimi i saj. Gjithashtu Shoqëria ka marrë masa për parandalimin ose eliminimin e mundshëm të shkaqeve të mungesës së likuiditetit.

2.6 Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Reja ose të Rishikuara dhe Interpretimeve

2.6.1 Standarde dhe Interpretime të hyra në fuqi në periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), janë në fuqi për periudhën raportuese:

- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** – Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtra ose Afatgjata (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2024).
- **Ndryshime në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** – Detyrimet Afatgjata me Kushte Detyruese (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2024).
- **Ndryshime në SNK 7, "Pasqyra e Ndryshimeve në Mjetet Monetare dhe SNRF 7 Instrumentat Financiarë - Dhënie e Informacioneve Shpjeguese"** – Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2024).

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

- **Ndryshimet në SNRF 16, "Qiratë"** – Detyrimi nga Qiraja në një Shitje dhe Marrje të Mëpasshme me Qira (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2024).

Zbatimi i këtyre standardeve të reja, ndryshimeve të standardeve ekzistuese dhe interpretimeve nuk sjellë ndonjë ndryshim material në këto pasqyra financiare.

2.6.2 Standarde dhe Interpretime të publikuara por ende jo në zbatim

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimi i ri ishin publikuar, por ende jo në zbatim:

- **Ndryshime në SNK 21 "Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit"** – Mungesa e Këmbyeshmërisë (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2025, lejohet zbatimi më i hershëm).
- **Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7 Instrumentet Financiarë dhe Instrumentet Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese** – Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2026, lejohet zbatimi më i hershëm).
- **SNRF 18 "Paraqitja dhe Dhënie e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrave Financiare"** – SNRF 18 zëvendëson SNK1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2027, lejohet zbatimi më i hershëm).
- **SNRF 19, "Filialet pa Përgjegjësi Publike"** (në fuqi për periudha vjetore të cilat fillojnë më ose pas 1 janar 2027, lejohet zbatimi më i hershëm).

Shoqëria ka zgjedhur të mos zbatojë këto standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime të reja përpara datës së tyre efektive.

3. Politikat kryesore kontabël

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zërat monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbëhen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të Lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi mesatar 2024	Kursi i raportimit 2024	Kursi mesatar 2023	Kursi i raportimit 2023
ALL / EUR	100.70	98.15	108.75	103.88

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3.2 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur perfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale njihet në pasqyrën e rezultatit dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse bazuar në metodën lineare.

Jeta e dobishme e disa kategorive të aktiveve afatgjata vlerësohet si vijon:

Kategoria	Jeta e dobishme
Pajisje zyre	5 vite
Struktura IT dhe pajisje të tjera	5-10 vite

Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Përmirësimet e ambienteve me qira amortizohen për periudhëm më të shkurtër mes afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.3 Instrumenta financiare

Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, që përfshijnë llogaritë e arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente, të pagueshmet dhe huatë afatshkurtra. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumente që nuk maten me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë që i atribuohen.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë për flukset e mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojnë ose nëse Shoqëria transferon aktivin financiar një pale tjetër pa mbajtur kontrollin ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare trajtohen në datën e tregtimit, pra në datën që Shoqëria angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të specifikuara në kontratë përfundojnë, shkarkohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në thirrje me bankat, investime të tjera afatshkurtra shumë likuide me maturim prej tre muajsh ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra të saj. Paraja dhe ekuivalentët e saj fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar, minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Të pagueshmet

Të pagueshmet fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e tyre të amortizuar.

Huatë afatshkurtra

Huatë afatshkurtra fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse dëshmitë objektive tregojnë se një ose më shumë ngjarje kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të ardhshme të vlerës së aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me një aktiv financiar të matur me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të parashikuara, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivet financiare individuale të rëndësishme janë testuar për zhvlerësim në baza individuale. Aktivet financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në Shoqërinë që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi kthehet në qoftë se kthimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, si dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit.

(a) Aktivet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare konsiderohet të përafrohet me vlerën e tyre kontabël, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

(b) Detyrimet financiare të mbartura me koston e amortizuar

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Vlera kontabël e të pagueshmeve dhe huamarrjes afatshkurtër konsiderohet si vlerë e drejtë e përafërt, për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

3.4 Parapagimet

Parapagimet maten me kosto minus provizionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që do të klasifikohet si afatgjatë pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo Shoqëria merr kontrollin e aktivitetit dhe pret nga ky aktiv përfitime ekonomike të ardhshme. Parapagimet e tjera njihen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një tregues se aktiviteti, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të merren, vlera e mbartur e parapagimit zhvlerësohet dhe një humbje nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin.

3.5 Kapitali aksionar

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

3.6 Të ardhurat

Njohja e të Ardhurave sipas SNRF 15 (i zbatueshëm që prej 1 Janar 2019)

Të ardhurat janë fitime të gjeneruara gjatë aktivitetit të zakonshëm të Shoqërisë. Të ardhurat njihen për shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumën e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen.

Njohja e të Ardhurave sipas SNK 27 (i rishikuar në 2011 dhe i zbatueshëm nga janar 2013).

Kompania njeh të ardhurat nga dividendët e marrë nga filialet e saj kur vendoset e drejta për të marrë pagesën. Kjo zakonisht ndodh kur dividendi deklarohet nga filiali dhe kompania mëmë ka të drejtë të marrë pagesën. Dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si të ardhura financiare në periudhën në të cilën është deklaruar dividendi.

Dividendët e marra nga filialet llogariten në bazë të përqindjes së pronësisë së shoqërisë mbajtëse në filial. Kompania njeh të ardhurat nga dividendët në periudhën në të cilën filiali deklaron dividendin.

Të ardhurat nga dividendët nuk njihen sipas SNRF 15 pasi nuk plotësojnë kriteret për të ardhurat nga kontratat me klientët. Në vend të kësaj, ajo klasifikohet si e ardhur financiare në pasqyrat financiare të veçanta të shoqërisë mëmë.

3.7 Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, Shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të vet dhe të punonjësve në përputhje me legjislacionin lokal për kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Kostot e Shoqërisë janë përfshirë në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ndodhin.

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes (nëse ka), dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje me metodën e interesit efektiv.

3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi-fitimi njihet në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një tatim i shyrë njihet deri në atë vlerë ku mund të pritët që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme. Aktivët e njohura nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Trajtimet e pasigurta tatimore

Trajtimet e pasigurta tatimore të Shoqërisë rishikohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet njihen për trajtimet e tatimit mbi të ardhurat për të cilat drejtimi gjykon se me shume është e mundshme sesa jo, që të rezultojë në detyrim tatimor shtesë nëse trajtimet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që kanë hyre në fuqi ose janë miratuar deri në fund të periudhës raportuese, dhe ndonjë vendim gjykate për çështje të ngjashme. Detyrimet për gjoba, kamatëvonesa dhe tatime të tjera përveç atyre mbi të ardhurat, njihen bazuar në vlerësimin me të mire të drejtimit për shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç kamatëvonesave dhe gjobave, njihen tek shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat.

Rregullimet për trajtimet e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat në lidhje me interesin dhe gjobat njihen tek shpenzime financiare dhe fitime/(humbje) të tjera, neto, respektivisht.

4. Investime në Filiale

Investimet në filiale më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Top Fruit shpk	208,155,000	156,225,000
Ener Trade shpk	20,000,000	20,000,000
Professional Marketing Albania shpk	23,830,000	23,830,000
INFOTELECOM shpk	20,000,000	20,000,000
ETMT shpk	50,000	50,000
Aksione Albsolar 3 shpk	5,100	5,100
Solar Park Gjorice shpk	102,500	-
Totali	272,142,600	220,110,100

Gjatë vitit 2024 shoqëria GJONAJ GROUP HOLDINGS shpk ka blerë një kuotë të shoqërisë Solar Park Gjorice shpk, e cila përfaqëson 97% të kapitalit të shoqërisë së blerë.

5. Aktive Jo-Materiale

Aktive jo-materiale, të cilat përfaqësojnë blerjen e kutove në shoqëri të tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Parapagime të dhëna Per AA Jomateriale	15,664,500	15,664,500
Totali	15,664,500	15,664,500

Shoqëria GJONAJ GROUP HOLDINGS shpk ka bërë parapagime për blerjen e kutave në shoqërinë Green Vitality shpk dhe StarNova shpk.

6. Investime në aktive financiare

Ivestimet në aktive financiare më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 përbëhet si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Të tjera financiare- Eurobon	766,588,797	820,247,274
Totali	766,588,797	820,247,274

Investimet në aktive financiare përbëhen nga investime në Euro-Bond të qeverisë shqiptare me afat maturimi 5 vjeçar. Maturiteti përfundimtar i Euro Bondit është më 09 qershor 2028.

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***7. Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Kërkesa të arkëtueshme	1,423,042	-
Totali	1,423,042	-

8. Të tjera të drejta të arkëtueshme

Të tjera të drejta të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Te ardhura te llogaritura	23,163,400	27,999,427
Hua per palet e lidhura Green Nat	1,057,698,774	10,388,000
Hua per palet e lidhura Info Telecom	209,334,519	-
Hua per palet e lidhura	131,310,762	813,105,432
Totali	1,421,507,455	851,492,859

Të ardhura të llogaritura janë interesat nga investimi në Euro Bond të llogaritura, ndërsa pjesa tjetër e të drejtave të arkëtueshme janë huatë përkundrejt palëve të lidhura.

9. Të tjera të arkëtueshme

Të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
TVSH e arkëtueshme	25,089	4,076
Parapagime të dhëna	134,465,859	110,684,256
Totali	134,490,948	110,688,332

10. Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Mjete monetare EUR	16,453,853	2,375,309
Mjete monetare USD	-	-
Mjete monetare GBP	-	-
Mjete monetare ALL	334,273	116,318
Totali	16,788,126	2,491,627

Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë mjetet monetare në llogaritë bankare të cilat përbëhen si vijon: llogari rrjedhëse në Euro dhe Lekë pranë bankave Raiffeisen Bank Albania, Intesa SanPaolo Albania, ABI Bank.

11. Kapitali

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 99,220,506.4 Lekë i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 99,220,506.4 Lekë (2023: 99,220,506.4 Lekë i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 99,220,506.4 Lekë)

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

Fitimi i vitit 2023 është shpërndarë si më poshtë:

- Shoqëria ka shpërndarë dividendë gjatë 2024 me vlerë bruto 813,322,309 lekë. Ky dividend përbëhet nga shuma prej 100,000,000 lekë për të cilën është mbajtur tatim mbi dividendin në masën 8% në Republikën e Shqipërisë dhe shuma prej 713,322,308 lekë, që i përket dividendit të përfutur nga pjesëmarrja në shoqërinë ETMT ENERGY DOEL me seli në Maqedoni, tatimi mbi dividendin për të cilën është paguar në Maqedoni.
- Shoqëria ka mbuluar humbjet e mbartura në vlerën 185,228 lekë
- Shoqëria ka krijuar rezervë ligjore në shumën 95,667,397 lekë dhe rezervë të tjera në shumën 1,004,173,002 lekë.

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Kapitali i Nënshkruar	99,220,506	99,220,506
Rezerva ligjore	95,667,397	-
Rezerva të tjera	1,004,173,002	-
Humbja e mbartur	-	(185,228)
Fitimi i vitit	930,603,267	1,913,347,916
Totali i Kapitalit	2,129,664,172	2,012,383,214

12. Detyrime financiare afatgjata

Detyrimet financiare afatgjata më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Hua nga palet e lidhura Info Telecom	335,752,894	-
Hua bankare afatgjate	151,856,610	-
Totali	487,609,504	-

Gjatë vitit 2024 shoqëria ka marrë kredi në vlerë 1,500,000 Euro me afat 10 vjeçar nga ABI Bank për qëllime investimi në pjesëmarrje, me interes Euribor + 2.5%.

13. Detyrime Financiare afatshkurtra

Detyrimet financiare afatshkurtra më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Hua për palët e lidhura - Ener Trade	-	6,232,800
Totali	-	6,232,800

14. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	9,850,960	1,960,714
Totali	9,850,960	1,960,714

Llogaritë e pagueshme përbëhen kryesisht nga llogari të pagueshme me palët e lidhura me shoqërinë Info-Telecom shpk në shumën 9,813,313 lekë, të cilat përfaqësojnë interesat për financimin e bërë nga Info-Telecom shpk për kundrejt GJONAJ GROUP HOLDINGS shpk.

15. Të pagueshme ndaj personelit

Të pagueshme ndaj personelit më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	109,854
Totali	-	109,854

16. Të pagueshme të tjera

Të tjera të pagueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2024	Më 31 Dhjetor 2023
Detyrim për Sigurimet Shoqërore & Shëndetsore	60,106	8,110
Detyrim për Tatimin në burim	1,420,726	-
Totali	1,480,832	8,110

17. Shpenzime për personelin

Shpenzimet për personelin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Pagat	1,280,382	924,000
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	83,109	47,100
Totali	1,363,491	971,100

18. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Shpenzime sigurimi	399,978	-
Qira	305,503	-
Taksa lokale	74,500	89,250
Shpenzime noteriale	-	19,589
Sherbim mirembajtje website	-	12,520
Gjoha dhe penalitete	-	301
Shpenzime të tjera	1,340,914	9,698
Totali	2,120,895	131,358

19. Të ardhura të tjera financiare

Të ardhura të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të ardhura të tjera nga pjesëmarrjet	1,006,885,592	1,922,547,600
ENER TRADE	737,154,406	448,126,605
INFOTELECOM	269,731,186	760,000,000
ETMT	-	714,420,995
Të ardhurat nga investimet	37,558,934	27,999,427
Të ardhura nga huatë pjesë e aktiveve afatgjata	1,675,019	-
Totali	1,046,119,545	1,950,547,027

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***20. Shpenzime financiare, neto**

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 janë të përbëra si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Te ardhura financiare:		
<i>Të ardhura nga interesat</i>		
<i>Të ardhura të parealizuara nga kembimet</i>	15,086,378	-
	15,086,378	-
Shpenzime financiare:		
<i>Shpenzime Interesi</i>	(17,663,593)	(12,925,330)
<i>Komisione bankare</i>	(1,804,730)	(50,159)
<i>Shpenzime të tjera ndërmjetësimi</i>	(501,750)	(840,160)
<i>Humbje të parealizuara nga kembimet</i>	(107,148,197)	(22,319,84)
	(127,118,270)	(36,096,633)
Totali	(112,031,892)	(36,096,633)

21. Shpenzimi i tatim-fitimit

Bazuar në legjislacionin shqiptar norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 15% (2023: 15%). Shoqëria të ardhurat kryesore janë të ardhura nga pjesëmarrjet në investime, të cilat janë tatuar në shoqëritë përkatëse dhe si rrjedhojë shoqëria nuk tatohet për këto të ardhura. Gjithashtu, shoqëria përfiton të ardhura nga interesi në investime në Eurobond, për të cilat është mbajtur tatimi në burim në masën 15% nga banka në momentin e pagesës së interesit. Të ardhurat nga interesi janë objekt i mbajtjes së tatimit në burim dhe përjashtohen si të ardhura të tatueshme në deklaratën e tatim fitimit. Për 2024 shoqëria ka dhënë hua shoqërisë Solar Park Gjoricë shpk, dhe nga kjo huadhënie ka përfituar interesa në vlerën 1,675,019 lekë mbi të cilën është mbajtur tatim në burim në vlerën 251,253 Lekë.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë-deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final.

22. Transaksionet me palë të lidhura

Një transaksion me palë të lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

Kontrolli është fuqia për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga veprimtaritë e saj. Kontrolli supozohet të ekzistojë, kur shoqëria mëmë, zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të filialit. Shoqëria Mëmë e cila mban kontrollin ekonomik dhe Pala kontrolluese përfundimtare është GJONAJ GROUP HOLDINGS shpk.

Në datën e raportimit financiar, shumat dhe transaksionet e mëposhtme u korrespondojnë palëve të lidhura:

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga GJONAJ GROUP HOLDINGS		
Solar Park Gjorice shpk	1,423,042	-
Hua nga GJONAJ GROUP HOLDINGS		
Marin Gjonaj	125,247,836	813,110,532
Green Nat	1,057,698,774	10,388,000
INFO-TELECOM Shpk	209,334,519	-
Solar Park Gjorice shpk	2,367,280	-
TOP FRUITshpk	3,700,746	-
Të pagueshme për GJONAJ GROUP HOLDINGS		
Infotelecom	9,813,313	1,937,847
Hua për GJONAJ GROUP HOLDINGS		
Albsolar 3 shpk	5,100	5,100
INFO-TELECOM Shpk	335,752,894	-
ENER TRADE Shpk	-	6,232,800
Volumi transaksioneve GJONAJ GROUP HOLDINGS		
Të ardhurat		
Të ardhura nga interesi	1,675,019	-
Të ardhura nga Dividentet	1,006,885,592	1,922,547,600
Shpenzimet		
Shpenzime për interesa	17,664,193	1,947,734

27. Menaxhimi i riskut financiar

Drejtimi i Shoqërisë ka përgjegjësinë kryesore për krijimin dhe mbikqyrjen e një kuadri të menaxhimit të riskut për Shoqërinë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë synojnë: të identifikojnë dhe analizojnë risqet që ndesh Shoqëria; të vendosin kufij të përshtatshëm të riskut; të kontrollojnë dhe monitorojnë risqet dhe repektimin e kufijve të risqeve të vendosura. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të risqeve rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria përmes trajnimeve, standardeve dhe procedurave të menaxhimit, synon të mbajë një mjedis të disiplinuar dhe bashkëveprues nv të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrat e tyre.

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve në vijim lidhur me përdorimin e instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risku i likuiditetit
- risku i tregut (risku i monedhës, risku i normës së interesit, risku i çmimit të mallit)

Risku i kreditit

Instrumentet financiare, të cilat mund ta ekspozojnë Shoqërinë ndaj riskut të kreditit, konsistojnë kryesisht në llogari të arkëtueshme të tjera të arkëtueshme dhe mbajtja e arkës. Risku i kredisë për shoqërinë menaxhohet duke vendosur mjetet monetare dhe ekuivalentë të tjerë në institucione financiare të cilësisë së lartë. Risku maksimal i kreditit ndaj të cilit është e ekspozuar Shoqëria është si më poshtë:

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë		
Gjendje, jo të kufizuara apo të zhvlerësuara	16,788,126	2,491,627
Gjendje, jo të kufizuara por të zhvlerësuara sipas SNRF 9		
Zhvlerësimi		
Total	16,788,126	2,491,627
Llogari të arkëtueshme		
Gjendje, jo të kufizuara apo të zhvlerësuara	1,674,166	-
Gjendje, jo të kufizuara por të zhvlerësuara sipas SNRF 9		
Zhvlerësimi		
Total	1,674,166	-

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit në biznesin e saj, sepse është e mundur që klientët të mos mundin të shlyejnë detyrimet e tyre financiare. Shoqëria e strukturon nivelin e riskut të kreditit duke vendosur limite në sasinë e riskut që pranon nga kundërpartitë si dhe duke diversifikuar portofolin e saj të kreditit. Limitet në nivelin e riskut të kreditit aprovohen në mënyrë të rregullt nga drejtimi. Këto risqe monitorohen në mënyrë të rregullt si dhe janë subjekt i rishikimeve vjetore apo rishikimeve më të shpeshta.

Risku i likuiditetit

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të likuiditetit. Detyrimet financiare të saj janë të kufizuara vetëm në huamarrje ndaj Shoqërisë mëmë. Shumat e paraqitura më poshtë janë aktivet dhe detyrimet financiare të Shoqërisë në bazë të maturimit të tyre.

	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
31 Dhjetor 2024				
Aktive financiare				
Investime ne aktive financiare	-	-	766,588,797	766,588,797
Llogari të arkëtueshme	-	1,423,042	-	1,423,042
Të tjera të drejta afatshkurtra	-	0	1,421,507,455	1,421,507,455
Të tjera të arkëtueshme	-	134,490,948	-	134,490,948
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	16,788,126	-	-	16,788,126
Totali	16,788,126	135,913,990	2,188,096,252	2,340,798,368
Detyrime financiare				
Detyrime financiare	-	-	-	-
Detyrime tregtare	37,647	9,813,313	-	9,850,960
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	-	-	-
Të pagueshme për detyrime tatimore	1,480,832	-	-	1,480,832
Të tjera detyrime afatshkurtra	-	-	-	-
Total	1,518,479	9,813,313	-	11,331,792
Pozicioni neto i likuiditetit	15,269,647	126,100,677	2,188,096,252	2,329,466,576

GJONAJ GROUP HOLDINGS Shpk

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024
(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

31 Dhjetor 2023	Më pak se 6 muaj	6 deri në 12 muaj	Më shumë se një vit	Totali
<i>Aktive financiare</i>				
Investime ne aktive financiare	-	-	820,247,274	820,247,274
Llogari të arkëtueshme	-	-	851,492,859	851,492,859
Të tjera të drejta afatshkurtra	-	110,688,332	-	110,688,332
Të tjera të arkëtueshme	-	-	-	-
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	2,491,627	-	-	2,491,627
Totali	2,491,627	110,688,332	1,671,740,133	1,784,920,092
<i>Detyrime financiare</i>				
Detyrime financiare	-	6,232,800	-	6,232,800
Detyrime tregtare	22,867	1,937,847	-	1,960,714
Të pagueshme ndaj punonjësve	109,854	-	-	109,854
Të pagueshme për detyrime tatimore	8,110	-	-	8,110
Të tjera detyrime afatshkurtra	-	0	-	-
Total	140,831	8,170,647	-	8,311,478
Pozicioni neto i likuiditetit	2,350,796	102,517,685	1,671,740,133	1,776,608,614

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me pagesat që kryen ndaj furnitorëve si dhe Shoqërive të cilat janë palë të lidhura.

Kontratat e lidhura me furnitorët dhe me palët e lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë të emëruara në Euro.

Shoqëria nuk ka përdorur instrumente derivative që të mbrohet ndaj ekspozimit të normës së interesit dhe kurseve të këmbimit.

Aktivët dhe detyrimet e Shoqërisë sipas valutës në 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

31 Dhjetor 2024	EUR	ALL	Total
<i>Aktive financiare</i>			
Investime ne aktive financiare	766,588,797	-	766,588,797
Llogari të arkëtueshme	1,423,042	-	1,423,042
Të tjera të drejta afatshkurtra	1,026,930,200	394,577,255	1,421,507,455
Të tjera të arkëtueshme	-	134,490,948	134,490,948
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	16,453,853	334,273	16,788,126
Totali	1,811,395,892	529,402,476	2,340,798,368
<i>Detyrime financiare</i>			
Detyrime financiare	-	-	-
Detyrime tregtare	8,871,230	979,730	9,850,960
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	-	-
Të pagueshme për detyrime tatimore	-	1,480,832	1,480,832
Të tjera detyrime afatshkurtra	-	-	-
Total	8,871,230	2,460,562	11,331,792
Pozicioni neto	1,802,524,662	526,941,914	2,329,466,576

GJONAJ GROUP HOLDINGS Sh.p.k**Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024***(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

31 Dhjetor 2023	EUR	ALL	Total
<i>Aktive financiare</i>			
Investime në aktive financiare	820,247,274	-	820,247,274
Llogari të arkëtueshme	-	-	-
Të tjera të drejta afatshkurtra	751,709,735	99,783,124	851,492,859
Të tjera të arkëtueshme	-	110,688,332	110,688,332
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	2,375,309	116,318	2,491,627
Totali	1,574,332,318	210,587,774	1,784,920,092
<i>Detyrime financiare</i>			
Detyrime financiare	6,232,800	-	6,232,800
Detyrime tregtare	1,937,847	22,867	1,960,714
Të pagueshme ndaj punonjësve	-	109,854	109,854
Të pagueshme për detyrime tatimore	-	8,110	8,110
Të tjera detyrime afatshkurtra	-	-	-
Total	8,170,647	140,831	8,311,478
Pozicioni neto	1,566,161,671	210,446,943	1,776,608,614

28. Angazhime, garanci dhe detyrime të mundshme

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë. Veçanërisht legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili u miratua ose u miratua në mënyrë thelbësore në fund të periudhës së mëparshme të raportimit, i nënshtrohet interpretimeve të ndryshme kur zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Si pasojë, pozicionet tatimore të marra nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar që mbështesin pozicionet tatimore mund të kundërshtohen nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për t'u rishikuar nga autoritetet në lidhje me taksat për pesë vite kalendarike para vitit të rishikimit.

Me 31 dhjetor 2024, Shoqëria nuk rezulton të jetë e përfshirë në pretendime të ngritura nga palë të treta apo çështje ligjore. Drejtimi mendon se pozicioni financiar i Shoqërisë nuk do të ndikohet negativisht në qoftë se kjo e fundit do të përballet me ndonjë pretendim të ngritur nga një palë e tretë.

28. Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme përveç atyre mësipër, pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë rregullim ose paraqitje në këto pasqyra financiare.